



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr.163, datë 05.07.2022

PËR

**“FILLIMIN E PROCEDURAVE TË VERIFIKIMIT TË PASURISË DHE FIGURËS
PËR KANDIDATËT QË KANË KANDIDUAR PËR POZICION DREJTUESI, TË
KUALIFIKUAR ME VENDIMIN NR.152, DATË 27.06.2022,
TË KËSHILLIT TË LARTË TË PROKURORISË”**

Bazuar në nenin 149/a, pika 1, germa “a”, të Kushtetutës, në nenet 159 pika 2 dhe 190 pika 2, të ligjit Nr.115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, në pikat 2-7 të nenit 32 dhe në pikat 7-8 të nenit 48, të ligjit Nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, në rregulloren “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin, emërimin si magjistrat dhe caktimin në pozicion të kandidatëve për prokurorë, si dhe për zhvillimin e karrierës së prokurorëve” e ndryshuar, në nenin 9 pika 4, të Rregullores “Për miratimin e rregullores mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë në pozicionin e drejtuesit në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm”, si dhe pas u njoh me relacionin e propozuar nga Komisioni i Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

VENDOSI:

- I. Të fillojë procedurat e verifikimit të pasurisë dhe figurës për kandidatët që kanë kandiduar për pozicion drejtuesi, kualifikuar me vendimin Nr.152, datë 27.06.2022, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, si më poshtë:
 1. Çlirim Sino, kandidat për Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier.
 2. Elida Hoxhaj, kandidat për Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier.
 3. Elion Mustafaj, kandidat për Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier.
 4. Ervisa Hyka, kandidat për Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier.
 5. Genci Mane, kandidat për Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier.



6. Suela Beluli, kandidat për Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier.
- II. Ngarkohet Komisioni i Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale dhe Njësia e Mbështetjes së Komisioneve në Departamentin e Shërbimeve Ligjore për ndjekjen e këtij procesi.
- III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare web të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.
- IV. U shpall në Tiranë, sot më datë 05.07.2022.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË



KRYETAR
Alfred Balla

ZV/KRYETAR
Tartar Bazaj

ANËTAR
Sokol Stojani

ANËTAR
Bujar Sheshi

ANËTAR
Nurihan Seiti

ANËTAR
Eloida Goxhi

ANËTAR
Esmeralda Keshi

ANËTAR
Ludovik Dodaj

ANËTAR
Zeqir Hoda

ANËTAR
Mirela Bogdani